



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr. 68 , datë 1.10.2018

PËR

**“SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SUBJEKTIT REGJISTRUES TË
DOMAINEVE NËN .AL “WEBHOST SH.P.K” PËR KUNDËRSHTIMIN E
PJESSHËM TË VENDIMIT NR. 41 DATË 04.06.2018 TË KËSHILLIT DREJTUES TË
AKEP””**

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

| | | |
|-----------------|----------|---------|
| 1. Z. Ilir | Zela | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Edlira | Dvorani | Anëtar |
| 4. Znj. Ketrin | Topçiu | Anëtar |
| 5. Znj. Klarina | Allushi | Anëtar |

dhe sekretare e Këshillit Drejtues Znj. Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 01.10.2018, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për Funkionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, dhe Rregullores së Brendshme të Funkionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7 datë 16.02.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- **“Shqyrtimin e ankimit administrativ të subjektit Regjistrues të domaineve nën .al “Webhost sh.p.k” për kundërshtimin e pjesshëm të Vendimit Nr. 41, datë 04.06.2018” të Këshillit Drejtues të AKEP”.**

BAZA LIGJORE:

1. Gërma k) e nenit 8 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji 9918/2008**);

Adresa: Rr. “Reshit Çollaku” Tiranë, Tel : ++ 355 4 2259 571 Fax : ++ 355 4 2259 106, www.akep.al, info@akep.al

2. Nenet 128 e vijues të Ligjit nr. 44/2015, “Kodit i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (*ligji44/2015*);
3. Rregullore Nr. 02, datë 21.02.2008 për “Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domaineve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”, e ndryshuar;
4. Vendimi Nr.67, datë 01.10.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar”.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Ankim Administrativ i datës 16.07.2018 (nr.1967 Prot, datë 16.07.2018, i AKEP) i Regjistruerit të domaineve nën .al “Webhost sh.p.k.”;
2. Projekt Vendimi për shqyrtimin e ankimit administrativ të subjektit regjistruer të domaineve nën .al “Webhost sh.p.k” për kundërshtimin e pjesshëm të Vendimit të Këshillit Drejtues nr.41, datë 04.06.2018;
3. Relacionin shoqërues të projektvendimit;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

I. NË ASPEKTIN PROCEDURAL:

1. AKEP, pasi mori në shqyrtim ankimin administrativ të Regjistruerit të domaineve nën .al “Webhost sh.p.k.”, ndaj Vendimit të KD-së Nr. 41, datë 04.06.2018, “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr.2, datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”” e ndryshuar, konstaton se, ankimi është paraqitur brenda afateve ligjore dhe plotëson kushtet e pranimit sipas nenit 132 dhe 135 të Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

II. NË ASPEKTIN E TRAJTIMIT NË THELB TË ÇËSHTJES:

2. Regjistruesi “Webhost sh.p.k.”, me shkresën nr. 001 Prot, datë 16.07.2018, (nr.1967, datë 16.07.2018 i AKEP), ka paraqitur pranë AKEP ankimin administrativ kundër Vendimit nr.41, datë 04.06.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për disa shtesa dhe

ndryshime në Rregulloren nr.2, datë 21.02.2008, “Për regjistrimin e domaineve nën.al, dhe nëndomainet .gov.al, mil.al, edu.al, com.al, org.al dhe .net.al””;

3. Regjistruesi shpjegon se pasi është njohur me Vendimin nr.41, datë 04.06.2018, të Këshillit Drejtues të AKEP, legjitimohet plotësisht për të paraqitur këtë ankim duke parashtruar dhe pretendimet mbi aktin administrativ në fjalë si më poshtë:

i. **Në lidhje me pikën 7.1 të nenit 7**, të Rregullores nr. 2, datë 21.02.2008, “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën.al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar”, regjistruesi në fjalë ka ngritur pretendimin se AKEP me Vendimin nr. 41, datë 04.06.2018, ka marrë atributet e një organi ligjvënës, duke kufizuar të drejtat e subjekteve, në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës së RSH-së. Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 41 datë 04.06.2018, sipas regjistruesit “Webhost sh.p.k.” kufizon lirinë ekonomike në një treg të lirë dhe konkurrencial, të mbrojtur nga neni 11 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Duke përcaktuar një numër domainesh të caktuar në 5 për individë dhe 15 domaine për subjekte juridike, AKEP ka kryer një kufizim të të drejtave, veçanërisht duke e ballafaquar këtë fakt me mundësinë e sotme të pakufizuar të të drejtave përveç kufizimit me ligj.

ii. Regjistruesi vijon me pretendimin se Vendimi i KD nr. 41, datë 04.06.2018 është në kundërshtim me parashikimet e ligjit procedural për organet e administratës publike, konkretisht nenin 4, “Parimi i Ligjshmërisë” të Ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”. AKEP nuk ka respektuar parashikimet e nenit 17, “Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit” të Ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi me pranimin e disa propozimeve dhe refuzimin e shumicës së propozimeve të sjella nga grupet e interesit ka shkelur parimin e barazisë në kushtet kur subjektet e zbatimit të rregullores që miratohet nga AKEP, janë në kushte të njëjta dhe i nështrohen të njëjtës paketë ligjore dhe praktikave përkatëse nuk ka rrugë dhe shteg për trajtim dhe pranim të diferencuar përveç parashikimit nga neni 17 i Kodit të Procedurave Administrative, në diskutimet e hapura nuk morrëm dhe nuk patëm justifikime objektive dhe ligjore dhe pse disa propozime të një prej regjistruëve u pranuan dhe në të njëjtat kushte dhe në të njëjtat rrethana shumica e propozimeve të pjesës dërmuese të regjistruëve të tjerë nuk u morën parasysh, mbi të gjitha, nuk u soll një rationale e mbështetur në akte ndërkombëtare dhe kombëtare.

iii. Shqetësimi i AKEP, si autoritet rregullator i cili ruan dhe ka të drejtë të ndërhyjë e disiplinon tregun si dhe të mbrojtë konsumatorin, në raport me vendimin e marrë nuk është proporcional me rrethanat objektive, duke mos sjellë një relacion me kufizimet teknike për një subjekt juridik se sa domaine duhet të ketë në posedim, duke vendosur numrin max 15, vendos vetveten në kushte konkurrence jo të drejtë pasi duke patur atributet e regjistruesit dhe duke e përjashtuar vetveten nga i njëjti rregull, e vendos veten në pozita më të favorshme krahasuar me regjistruesit e tjerë.

- iv. Vendimi i AKEP në kufizimet teknike të cilat nuk janë vetëm teknike por janë së pari kufizime të rëndësishme të drejtash, krijon kushtet për një disbalancë dhe mohim të lirisë së operimit në treg konform parashikimeve ligjore dhe përcaktimit të kërkesë- ofertë nga tregu i lirë, si agjenti më i saktë dhe më rregullator i një ekonomie të lirë në kushtet e dyshimeve të autoritetit për deviancë dhe deformim të tregut. Masa e marrë nuk është proporcionale dhe e studiuar, autoriteti mund të vendoste një masë të ndryshme që do të testonte efektet rregullatore për të parë në një periudhë 24 mujore ose 12 mujore, sjelljen e regjistruarve dhe tregut, të konsumatorit që merr shërbime.
- v. Në lidhje me gërmën g), të pikës 3, të Aneksit nr.1 të Rregullores nr. 2, datë 21.02.2008, e ndryshuar, në të cilën parashikohet se *“Mospërpërbushja e detyrimeve të mësipërme, çon në revokimin e regjistrimit nga AKEP”*, regjistruesi “Webhost sh.p.k.” ka paraqitur kundërshtimet e tij duke argumentuar se një formulim i tillë lë shteg për keqinterpretime të cilat duhen sqaruar dhe konkretizuar.
- vi. Në përfundim të të gjitha arsyetimeve të dhëna për kundërshtimet ndaj Vendimit nr. 41, datë 04.06.2018, të Këshillit Drejtues të AKEP, regjistruesi “Webhost sh.p.k.” ka dalë me propozimin se, formulimi më i drejtë në kushtet aktuale do të dukej në një fazë testuese dhe jo ligjshmërie të plotë, por që neni 7.1 i kësaj rregulloreje të formulohet me përmbajtjen si më poshtë:
“Numri i lejuar i domaineve .al përfshirë nëndomainet në posedim, është deri në 10 domaine për individët dhe deri 30 domaine për subjektet fizike dhe juridike private/tregtare (përfshirë Regjistruerit e domaineve .al), me kushtin që të vendosen në përdorim brenda një afati 1 (një) vjeçar....”

III. KONSTATIMET DHE ARSYETIMI I AKEP.

- 4. Në përgjigje të ankimit administrativ që ka sjellë regjistruesi “Webhost Sh.p.k.” qëndrimet e AKEP mbi pretendimet e këtij regjistrari paraqiten si vijon:
 - i. Në lidhje me pretendimin e ankimuesit për shkeljen e parimeve të ligjshmërisë, të barazisë, mosdiskriminimit, proporcionalitetit dhe transparencës, sqarojmë se, AKEP në ushtrimin e veprimtarisë së tij, është bazuar në objektivat rregullatorë dhe kompetencat e parashikuara në nenet 7 dhe 8 të ligjit nr. 9918/2008.
 - ii. Për sa i takon pretendimit se AKEP me Vendimin nr. 41, datë 04.06.2018, të Këshillit Drejtues ka marrë atributet e një organi ligjvënës, sqarojmë se numri i lejuar i domaineve nën .al sipas rregullit të ri të përcaktuar në pikën 7.1 b) të Rregullores nr.2, datë 21.02.2008, nuk përbën një numër kufizues (apo

censurues) mbi të drejtën e përdorimit të këtyre domaineve, por një rregull procedural kushtëzues sasior për të orientuar përdorimin e tyre efektiv sipas qëllimit për të cilin janë marrë në posedim, brenda një afati 1(një) vjeçar. Nëse një posedues ka nevojë për një numër më të madh domainesh nën .al, apo nëndomainesh të tij, sesa ai i përcaktuar në pikën 7/1 b) të Rregullores, duke arsyetuar nevojën, është i lejuar të pajiset nga AKEP me të drejtën e posedimit të tyre duke vendosur kushtin e përdorimit brenda afatit 1(një) vjeçar. Ky rregull është i sanksionuar në pikën 7/1 c) të Rregullores. Vendosja e këtyre rregullave është bërë nga AKEP, pasi është analizuar sjellja e deritanishme e të gjitha kategorive të poseduesve të domain.al, nevojat e tyre historike statistikore, rastet abuzive dhe keqpërdorimi për arsye interesi në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, duke ia nënshtruar paraprakisht vendimmarrjen një procesi të gjatë konsultimi publik dhe dëgjësive me palët e interesuara. Në mbrojtje të interesave legjitime të çdo poseduesi të domain.al dhe nëndomaineve të tij, për të mos lejuar keqpërdorimin e mëtejshëm abuziv dhe antiligjor, u vendos kushti i përdorimit të një numri të caktuar domainesh, por jo të kufizuar, brenda afatit 1(një) vjeçar, si dhe u parashikua investimi i AKEP si organ i shqyrtimit administrative të ankesave të mundshme nga subjektet e interesuara. Në vijim, theksojmë se këto rregulla janë në pajtim të plotë me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi dhe për rrjedhojë vlerësohet se nëpërmjet nenit 7/1/b, AKEP nuk ka bërë asnjë lloj kufizimi, por thjesht ka ushtruar kompetencat e tij ligjore si organ rregullator, për mbarëvajtjen e procesit të mirëadministrimit të domaineve nën .al dhe nëndomaineve të tij.

AKEP, në lidhje me këtë pretendim pranon në mënyrë të pjesshme kundërshtimin përkatës dhe me Vendimin Nr.67 datë 01.10.2018 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar”*”, ka miratuar ndryshimin se, *“Hyrja në fuqi e kufizimit të numrit të domaineve përcaktuar në nenin 7, pika 7.1 b) të Rregullores Nr. 2 të bëhet në mënyrë të shkallëzuar, 1 (një) vit nga data e hyrjes në fuqi të ndryshimeve në rregullore”*. Ky kufizim synon kalimin e emrave të domaineve tek përdoruesit e tyre. AKEP do të monitorojë përgjatë vitit këtë proces në mënyrë që të sigurohet që kjo periudhë tranzitore po përdoret sipas këtij qëllimi nga regjistrarët. Gjithashtu me Vendimin Nr.67 datë 01.10.2018 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar”*”, AKEP, ka miratuar ndryshimin se, *“Kjo masë e kufizimit të numrit të domaineve do të veprojë për një periudhë 2 vjecare nga fillimi i aplikimit të saj”*. AKEP, në bashkëpunim me regjistruesit do të çmojë nëse do të jetë e nevojshme mbajtja e kësaj mase në përfundim të kësaj periudhe”.

- iii. Më tej lidhur me pretendimin e regjistruesit “Webhost sh.p.k.” se shkronja g), pika 3, “Të drejtat dhe detyrimet e Regjistruesit”, të Aneksit 1, të Rregullores Nr.2, datë 21.02.2008, të ndryshuar, ku përcaktohet se revokimi i menjëhershëm i licencës në rast përsëritje, është një formulim që lë shteg për keqinterpretime të cilat duhen sqaruar dhe konkretizuar, AKEP sqaron se, pika 3, e Aneksit 1, të Rregullores Nr. 02 datë 21.02.2008 *“Për Regjistrimin dhe Administrimin e*

Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”, e ndryshuar; përcakton qartësisht cilat raste përkufizohen si shkelje. Në kuptim të gërmës u) të pikës 3, të Aneksit 1, të Rregullores së sipërcituar termi “Përsëritje” nënkupton se heqja eventuale e liçensës nuk bëhet në mënyrë të menjëhershme por pasi e tillë është konstatuar si shkelje nga AKEP, dhe në mënyrë të përsëritur regjistruesi dështon të marrë masat e duhura për të korrigjuar apo riparuar shkeljet e kryera. Kjo nënkupton se heqja e liçensës do të kryhet vetëm pasi regjistri tregohet tërësisht pasiv ndaj procedurës së paralajmërimit të ndërmarrë nga AKEP.

PER KETO ARSYE:

Bazuar në shkronjën k) të nenit 8, në pikën 1, të nenit 114 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenet 128 e në vijim të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të ankimit administrativ të regjistruetit “Webhost sh.p.k.” për kundërshtimin e pjesshëm të Vendimit nr. 41, datë 04.06.2018, të Këshillit Drejtues të AKEP.
2. Të njoftohet subjekti “Webhost sh.p.k” për këtë Vendim.
3. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga data e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të internetit të AKEP.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

KRYETAR

Illir ZELA

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Edlira DVORANI
3. Ketrin TOPÇIU
4. Klarina ALLUSHI